



Nr. i pr: 11/439
Dt: 12.08.2016

Adresa: Rruga: "William Walker", p.n
Kodi postar: 24000
Tel: 045/985-287

E-mail: dkaemalisheva@gmail.com

Në bazë të Nenit 8 të Ligjit të Punës, nr. 03/L-212, nenit 5 pika c,d të Ligjit për Arsimin në Komunitet e Republikës së Kosovës, nr. 03/L-068, Drejtoria për Arsim dhe Edukim shpall:

K O N K U R S

Për plotësimin e vendeve të lira të punës

Titujt e punës:

- 1. Një mirëmbajtës në Institucioni Çerdhja për Fëmijë " Zërat e Ëmbël" në Malishevë
Orari: Plotë – 40 orë në javë.**
- 2. Një punëtor-e teknike në SHFMU" Ismail Qemali" në Bellanicë.
Orari i plotë : - 40 orë në javë.**

Përshkrimi i detyrave të punës:

1. Zhvillon dhe arrin pëlqimin për planet e punës dhe afatet me menaxherin dhe stafin tjetër profesional për zbatimin e shërbimeve dhe produkteve përkatëse;
2. Kryen detyra të specializuara, sipas kërkesës, në fushën profesionale specifike në përputhje me ligjet, rregulloret, politikat dhe procedurat përkatëse, brenda afateve kohore të caktuara;
3. Kryen detyrat në fushën profesionale specifike me një shkallë të arsyeshme të pavarësisë, me mbikëqyrje dhe udhëzime të kohëpaskohshme;
4. Merr pjesë në grupe punuese në fushën profesionale specifike kur kërkohet një gjë e tillë.
5. Komunikon brenda institucionit dhe jashtë tij për shkëmbim të informatave dhe zhvillimin e punës në fushat e interesit të përbashkët;
6. Raporton rregullisht te mbikëqyrësi rreth progresit në lidhje me planet e punës të miratuara;
7. Mirëmban në aspektin teknik kopshtin e Çerdhes dhe kujdeset edhe për mirëmbajtjen teknike të objektit.(Kjo pikë vlen vetëm për pozitën e parë të konkursit).
8. Kryen çdo detyrë tjetër në fushën profesionale specifike, të cilat mund të kërkohen në mënyrë të arsyeshme kohë pas kohe.

Të gjithë të interesuarit që dëshirojnë të aplikojnë në këto vende të punës, janë të obliguar t'i marrin dhe dorëzojnë aplikacionet në Zyrën për pritjen e palëve në Komunë. Nga data 13.08.2016 deri më 29.08.2016. Dokumentet e dorëzuara të fotokopjohen, sepse pas dorëzimit nuk kthehen. Konkursi do të mbetet i hapur 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga dita e shpalljes së tij në të përditshmen " Epoka e re", dhe në tabelë të shpalljeve në Komunë. Për intervistë do të njoftoheni me kohë.